



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Report nga Takimi i Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor të Komunave të Republikës së Kosovës

Për: Shefat/Zyrtarët Ligjor të Komunave/pjesmarrësit e takimit MAPL-në dhe OSBE-në
Nga: Shqipe Arifaj – Zyrtare Ligjor e AKK-së
Kopje: z.Sazan Ibrahim – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së
Data : 5 dhjetor 2011
Subjekti : Raporti i takimit të pestë të Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor



5 dhejtor 2011, Restorant “Mansion” Hajvali/Prishtinë

HYRJE

Asociacioni i Komunave të Kosovës(AKK) organizoi takimin e pestë të Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor të Komunave të Republikës së Kosovës të AKK-së, për vitin 2011. Ky takim u organizua në formë të punëtorisë në bashkëpunim me MAPL-në dhe OSBE-në.

Qëllimi i takimit ishte mbledhja e zyrtarëve ligjor për të diskutuar për aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2011, si dhe planet për vitin 2012, aktivitet të cilat mund të jenë të përbashkëta me MAPL-në dhe OSBE-në.

Në këtë takim morën pjesë zyrtarët ligjor të Komunave, përfaqësuesit i MAPL-së, z.Agron Maxhuni, z.Besim Myrtezani, z.Blerim Hasani, zyrtarët e OSBE-së z.Jan Lueneberg, znj.Nensi Jasharaj, z.Arben Fetahu, përfaqësuesi i GTZ-së z.Driton Vatovci dhe zyrtarja ligjore e AKK-se znj.Shqipe Arifaj.

PËRMBLEDHJE

Takimin e hapi dhe e kryesoi kryesuesi i KZL-së z.Agim Salihu, i cili përshëndeti pjesmarrësit, tha se ky takim ka një përbërje më të madhe sepse organizohet së bashku me MAPL-në dhe OSBE-në, pastaj fjalën ia pasoi përfaqësuesit të OSBE-së.

z.Jan Lueneberg – Ju përshëndes të gjithëve dhe shprehi kënaqësinë që jeni pjesmarrës në këtë takim për të rishqyrtuar çështjet që i kemi kaluar, por të shohim si mund t'i kryejmë këto punë në të ardhmen. Ne po e mbështesim Kolegjiutin e Zyrtarëve Ligjor të AKK-së së bashku me MAPL-në dhe besojmë se ky bashkëpunim do të jep rezultate.

z.Agron Maxhuni- Përshëndetje, qëllimi i këtij takimi konsiston me rolin që e kanë zyret ligjore ose zyrtarët ligjor. Edhe Kryesuesit e Kuvendeve Komunale kanë kërkuar që edhe zyrtarët ligjor të jenë pjesë e grupeve ku shqyrtohen aktet juridike. Ne po punojmë në at drejtim që të bëjmë unifikimin e akteve juridike, kjo kërkohet edhe me Raportin e Progresit.

Kryesuesi – Të ndreuar zyrtar, së bashku me ftesën ju keni marrë edhe raportin e takimit të katërt, mirëpo nëse keni vërejtje, ju mund t'i dërgoni me email te zyrtarja ligjore e AKK-së.

Për të prezentuar raportet nga OSBE-ja fjalën e ka z.Jani më pastaj znj.Jasharaj ndërsa nga MAPL-ja do të prezentoj drejtori i Departamentit Ligjor z.Agron Maxhuni dhe unë nga AKK-ja.

Prezentimet e OSBE-së nga z.Jani Lueneberg

Shqyrtimi i Akteve Komunale:

– Qëllimi ishte vlerësimi i zhvillimit të takimeve të kuvendit komunal (në përputhje me kërkesat rregullative dhe procedurale)

Gjetjet kryesore:

- Progresi në shpalljen publike të takimeve të KK-së nuk respektohet plotësisht edhe në përgjithësi (për shembull mungesa e shpërndarjes së mjaftueshme të cilat mund të tërheqin më shumë banorë);
- (Mungesa e publikut në takimet e KK) ;
- Fillimi i konfliktit të interesave të votimit gjatë takimit të KK-së ;
- Zgjidhjen efektive të rasteve kur anëtarët e KK kanë mbajtur poste të dyfishta (të papajtueshme) ;
- Detyrimi ligjor në ofrimin e përkthimit verbal të respektohen në të shumtën e rasteve;

- Përkthimi dhe botimi i materialeve të mbledhjeve të KK-së të respektohen vetëm në disa raste ;

Rekomandimet:

- T'u përmbahen parimit të takimeve të hapura
- Të përkthehen/Publikohen materialet e takimeve
- Kryesuesi: forcimi/promovimi i rolit të KK-së si mbikëqyrës legjislative
- MAPL të vazhdoj dhe të zgjeroj aktivitetet e saja monitoruese dhe të këshillojë KK-të

Marrëdhënia në mes Institucioneve qendrore dhe lokale nga znj.Nensi Jasharaj

Qëllimi i raportit është Rivlerësimi i sistemit të komunikimit në mes të nivelit qendror dhe lokal gjatë procesit të hartimit të akteve komunale dhe procesi i shqyrtimit pas miratimit të tyre nga KK-ja.

Gjetjet specifike:

- Shfrytëzimi në rritje (nga komunat) të mjetit të konsultimit paraprak nga komunat për draft aktet komunale (Neni 83 i LVL)
- Krijimi i mekanizmave për të lehtësuar sistemin e komunikimit (Komisioni Ndërmintor, Pikat e Kontaktit Komunal)

Rekomandimet nga ky raport për Komunat:

- Vazhdimi i përdorimit të mjetit paraprak të konsultimit dhe informimi mbi aktivitetet legjislative të nivelit qendror në kohën e duhur;
- Konsolidimi i mëturjeshëm i sistemit të komunikimit (të caktojë zyrtarin nga zyra e kryetarëve të komunave të procedoj listën e akteve të miratuara, të përcaktojë rolin e pikave kontaktuese në procesin e shqyrtimit);
- Të vazhdohet me ristrukturimin e komponentit ligjor komunal në një zyrë të unifikuar ligjore dhe të krijoj zyra ligjore në ato komuna ku mungojnë;
- Përfshirja e zyrtarëve ligjor në procesin e hartimit të legjislacionit në ato komuna ku nuk ekzistojnë;

Për nivelim qendror (MAPL):

- Të vazhdojë të monitorojë seancat e KK-së duke rritur praninë e vëzhguesve në disa komuna;
- Gjithmonë ofroni opinionin me shkrim për rezultatin e shqyrtimit
- Sfida e rasteve në gjykatë në rast të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme në opinionet juridike;
- Të përmirësohet niveli i performancës së komisioneve ndër-ministore;

Në fund duhet cekur se zyrtarët ligjor komuanl janë deklaruar se për qdo lloj kërkesë apo këshille i drejtohen AKK-së.

Prezentimet e MAPL-së nga z.Agron Maxhuni

Projektregullorja për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale

Projektregullorja për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale është në procedure të draftimit, zyrtarët e DL do të angazhohen që gjatë këtij muaji të finalizohet ky draft.

Shfryetzoj rastit t'i falenderoj zyrtarët e OSBE-së për përkrahje si dhe përfaqësuesit e AKK-së të cilët janë anëtar të grupit punues për kontributin që po e japin në grupin punues.

Udhëzuesi për ngritjen e cilesisë së akteve komunale;

Mandati që iu është dhënë Kuvendeve Komunale të nxjerrin akte komunale është përcaktuar me nenin 12 të LVL-së. Kuvendet Komunale miratojnë këto akte komunale :

- Statutin,
- Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës,
- Rregulloret dhe vendimet për zbatimin e përgjegjësive.

Gjatë procesit të hartimit të akteve komunale përfshihen këto elemente:

- për qfar duhet të kemi kujdes gjatë hartimit;
- struktura e akteve komunale;
- miratimi i akteve komunale;
- objektivat e shqyrtimit administrativ,
- llojet e shqyrtimit dhe
- përvojat pozitive

Aktivitetet e Departamentit Ligjor/MAPL për vitin 2012

- Plotësimi dhe përmirsimi i Kornizës ligjore për Vetëqeverisjen Lokale;
- Standardizimi i akteve komunale;
- Rregullorja për publikimin e akteve komunale;
- Zhvillimi i bashkëpunimit ndërkomunal;

Pas preznetimit nga MAPL-ja, u shtruan pyetje të ndryshme nga zyrtarët ligjor.

Diskutuan: z.Ahmet Maksuti-Lipjan, z.Hevzi Matoshi-Gjilan, z.Ali Shala-Klinë,z.Isa Hyseni-Mitrovicë, znj.Qerime Koci-Skënderaj, z.Bajrush Laqi-Hani i Elezit, z.Avni Hoda-Kamenicë, z.Faruk Guri-Shtërpçë etj. U cek se ka raste kur MAPL-ja nuk iu kthen përgjegjjet për vendimet që i dërgojnë komunat për shqyrtimin e ligjshmërisë, po ashtu nxjerrja e disa rregulloreve komunale po bëhet në kundërshtim me ligjet në fuqi, u kërkua fuqizimi i zyreve ligjore respektivisht pozita e zyrtarit ligjor, u kërkua mbajtja e një takimi të përbashkët me kryetarët e komunave dhe zyrtarët ligjor, u cek se ka zbrazëtirë në procedura, se kur duhet të kyqet zyrtari ligjor në cilën fazë të procedurës për miratimin e një akti komunal, organizimi i ndonjë vizite studimore për zyrtarët ligjor etj.

z.Agron maxhuni – Vendimet që dërgohen në MAPL për shqyrtim të ligjshmërisë, përgjegjet i kthejmë te kryetarët e komunave; ka raste kur disa rregullore po janë në kundërshtim me ligjet, duhet pasur parasysh që ligjet po ndryshojnë andaj duhet edhe rregulloret të ndryshohen; ne do të bëjmë përpjekje për të fuqizuar rolin e zyrtarit ligjor në komuna aq sa kemi mandat;për fazat e procedurës, kjo çështje do të jetë pjesë e rregullores të cilën jemi duke e punuar.

z.Arben Fetahu- Edhe në këtë takim edhe në takim me Kryesuesit e Kuvendeve Komunale po kërkohen rezultate në fuqizim të zyrës ligjore ose pozitës së zyrtarit ligjor. Ka kaluar koha kur është kërkuar qfar zyre të formohet nëpër komuna. Për krijimin e strukturave do të kemi vështirë me iu ndihmuar se kjo është e kompetencë e pushtetit lokal. Ne mund të ju përkrahim, edhe sa vërejta unë janë dy çështje që OSBE-ja mund të kyqet në organizimin e përbashkët me kryetarët e komunave dhe zyrtarëve ligjor, dhe me organizimin e një vizite studimore për zyrtarët ligjor.

Prezentimet e AKK-së :

Prezantim i aktiviteteve të zhvilluara nga Kolegjiumi i Zyrtarëve Ligjorë në vitin 2011

Kryesuesi – KZL-ja, është formuar në vitin 2007, që 4 vite po funksionon mjaft mirë. Gjatë vitit 2011, kemi mbajtur 4 takime si kolegji, dhe disa takime veq kryesia, po ashtu takime dhe me institucione apo organizata tjera. Gjatë këtij viti, kemi diskutuar për projektligjet që kanë qenë në hartim apo plotësim-ndryshim, kemi dhënë komentet tona. Janë mbajtur trajnime për zyrtar ligjor në regjionin e Pejës, po ashtu kemi kërkuar që zyrtarët ligjor të trajnohen në fushat ku nuk kanë eksperiencë, shpresojmë që këto trajnime të mbahen gjatë vitit 2012.

Planet e Kolegjiumit për vitin 2012

Ne kërkojmë mbështetjen e MAPL-së dhe OSBE-së për përkrahje dhe bashkëpunim në aktivitete të përbashkëta, edhe pse Kolegjiumi planin e punës dhe caktimin e aktiviteteve në detale do ta bëj në fillim të vitit 2012, në koordinimin me AKK-në.

Znj.Shqipe Arifaj – Unë në emër të AKK-së falendrojë zyrtarët ligjor për pjesmarrje nëpër takime për kontributin e dhënë në Kolegji, falenderoj dhe MAPL-në dhe OSBE-në për bashkëpunim. Po ashtu në prezentimin e znj.Jasharaj nga OSBE-ja, u cek se zyrtarët ligjor janë deklaruar se për qdo çështje i drejtohen AKK-së, për pyetje apo këshilla, ne jemi munduar të ju kthejmë përgjegjjet me kohë dhe të ju ndihmojmë në zgjidhjen e paqartësive që keni pasur. Ju falenderojmë për besimin që keni në AKK, dhe AKK-ja mirëpret kërkesat apo qfar do lloj pyetje që do t'i parashtroni rreth punëve të ndërlidhen me zyret ligjore.

Kryesuesi – Po e përfundojmë këtë takim, ju falendrojmë të gjithëve për pjesmarrje, për prezentimet e tyre MAPL-në dhe OSBE-në, shihemi në takimet e vitit të ardhshëm.

REKOMANDIME

- Organizimi i një takimi të përbashkët mes kryetarëve të komunave dhe zyrtarëve ligjor;
- Organizimi i një vizite studimore për zyrtarët ligjor;
- Të vazhdojnë takimet e rregullta, të organizuara nga AKK-ja;
- Bashkëpunimi mes KZL-së dhe Departamentit Ligjor të MAPL-së do të jetë me i madh dhe më i konkretizuar , të shfrytëzohet këshillimi si mekanizëm paraprak ;
- Të organizohen trajnime(për pronë komunale, partneritetin publiko-privat, kontratat e koncesionit, etj);
- Angazhimi i KZL-së për të kontribuar në harmonizimin e ligjeve sektoriale me LVL-në ;
- Shqyrtimi i draftrregullores për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale ;
- Angazhimi i KZL-së së bashku me Departamentin Ligjor të MAPL-së, për të nxjerrur rregulloren për publikimin e akteve komunale në Gazetën Zyrtare;